

Tiranë, më 11.07.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 që gjenerohen nga shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universtare “Nënë Tereza” për 24 muaj”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 90524400-0

VLERA E FONDIT LIMIT / Vlera e pritshme e kontratave të Marrëveshjes Kuadër:

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes **5,672,000** (pesë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) **Leke pa TVSH** dhe **6,806,400** (gjashtë milion e tetëqind e gjashtë mijë e katërqind) **Leke me TVSH** dhe shumatorja e çmimeve për njësi është **394** (treqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, dhe nenit 52 “Marrëveshja Kuader” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

a) Operatori duhet të ketë certifikatën **ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b) Operatori duhet të ketë certifikatën **ISO 45001-2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

c) Operatori, duhet të ketë certifikatën **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambjentit”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kriteret **a, b dhe c** jane miratuar dhe vendosur nga anetari i Njesisë së Prokurimit qe ka specialitetin perkates, ne perputhje me germen “c” te pikes 1 te nenit 77 te Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 44 te VKM nr. 285 dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, i ndryshuar rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 ‘Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit publik’, rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr.3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 ‘Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise’ dhe mbështetur në Shkresën e Grupit te argumentimit **nr. 545/9**

Prot, datë 05.04.2024 Argumentimi i Fondit Limit për procedurën me objekt “Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 që gjenerohen nga shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universtare ‘Nënë Tereza’ për 24 muaj”, bashkelidhur kerkeses per rihapje procedure nga Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese nr. 545/19 Prot., datë 04.07.2024.

d) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A dhe B, ose Leje Mjedisore tipi A, lëshuar nga Ministria e Mjedisit , ku të përfshihet trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve me kod 18 01 02 dhe 18 01 03, dhe Licensë III.2.B, lëshuar nga QKB .

Mbetjet me kodin 18.01.02 “ *Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset e gjakut dhe rezervat e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)*” do të asgjësohen me incenerim.

Mbetjet me kodin 18.01.03 “*Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet*” do të asgjësohen me sterilizim ose incenerim.

Argumentimi: Kriteri **d)** u vendos ne mbështetje te Nenit 41, pika 5 e VKM nr. 285 dt.19.05.2021, si dhe nenit 77 pika 1) germa a) dhe c) e ligjit nr. 162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar.

Referuar Katalogut Shqiptar të Mbetjeve, të miratuar me VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve, këto mbetje janë konsideruar si Kod 18.01.02 dhe 18.01.03, metoda më e mirë dhe më efikase për të pasur një mbrojtje maksimale dhe për të shmangur pasojat qoftë mjedisore qoftë në popullatë, është metoda me hidroklavim/autoklavim dhe incenerim. Nisur dhe nga vetë titulli i procedurës që është: **Trajtim dhe Asgjësim...**referuar VKM Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për Lendfillet e Mbetjeve”, Pika II/f) ku citohet që: f) “*Trajtim*” nënkupton proceset (fizike, termike, kimike ose biologjike, përfshirë edhe ndarjen) të cilat ndryshojnë karakteristikat e mbetjeve me qëllim që të pakësojnë vëllimin dhe natyrën e rrezikshme të tyre, të lehtësojnë trajtimin ose të rrisin rikuperimin e tyre.., pra nevojitet trajtimi dhe më pas asgjësimi final i tyre, si dhe argumentimit të grupit të punës me **545/9 Prot, datë 05.04.2024** Argumentimi i Fondit Limit për procedurën me objekt “Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 që gjenerohen nga shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universtare ‘Nënë Tereza’ për 24 muaj”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo me e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, ”Për prokurimin publik”, i ndryshuar, [...]: *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës....., si dhe pika 1 dhe 2 e nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) **40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbimkonsulencë”**.*

Vendosja e ketyre kritereve behet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet paraqitjes së kërkuara me lartë, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021, të ndryshuar, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur. AK është e vetmja qendër terciare në RSH për këtë arsye praktika e vendosur ndër vite e cila ka rezultuar e suksesshme, është ajo e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik në tërësi.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

2.3 Kapaciteti teknik:

1) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme **në një vlerë jo më të vogël se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe kontrata përkatëse, ose / dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me gërmes c, të pikës 1 të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, në nenin 55/4 të VKM 285/2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 "Mbi hartimin e kritereve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik".

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2) Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Akt-Miratimi Higjeno-Sanitar** për impinatën ku do të kryhet aktiviteti, lëshuar nga ISHSH, detyrim që buron nga pika 10.3, kreu IV, VKM Nr.798, datë 29.9.2010 "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore".

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me gërmen "c", të pikës 1 të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, bazuar në ligjin nr. 7643, datë 02.12.1992 "Për inspektimin sanitar", i ndryshuar, në pikën 10.3, kreu IV, VKM Nr.798, datë 29.9.2010 "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore", si dhe rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 "Mbi hartimin e kritereve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik". Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet dokumentacionit vërtetues, që tregojnë se kushtet janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK. Parashikimi i regjistrimit të procesit të punës nga OE garanton zbatimin e plotë të kontratës së shpallur nga AK si dhe shmang mundësinë e abuzimit me zbatimin e kontratës.

3) OE për të vërtetuar funksionalitetin e Autoklavës/Hidroklavës dhe/ose Inceneratorit, duhet të paraqesë Autodeklaratë ku të deklarojë se Autoklava/Hidroklava dhe/ose Inceneratori janë të pajisura me printer i cili regjistron dhe printon çdo detaj të procesit të punës (*Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj.,*). Autodeklarata duhet të

shoqërohet me disa printime (minimalisht 2 ose 3 printime) të autoklavës/hidroklavës dhe inceneratorit, të paktën të muajit të fundit nga data e hapjes së procedurës.

Ky kriter u vendos në përputhje me gërmes c, te pikes 1 te nenit 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, në nenin 40 pika 6 gërma **b**) të VKM 285/2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 "Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit publik".

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK. Parashikimi i regjistrimit të procesit të punës nga OE garanton zbatimin e plotë të kontratës së shpallur nga AK si dhe shmang mundësinë e abuzimit me zbatimin e kontratës.

4) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te paraqese, minimalisht 3 punonjë, ku të përfshijë:

- **Një Ekspert Mjedisor**, të certifikuar nga Institucioni Përkatës (MTM), i punësuar në këtë shoqëri të vërtetuar me Kontratë Pune, Çertifikatë (Eksperti Mjedisor), CV dhe të figurojë në paktën në muajin e fundit në listëpagesat e OE, i cili do te bëjë monitorimin e procesit, dhe parandalimin e problemeve të ndryshme që mund të vijnë.
- **Një shofer**, të vërtetuar me Kontratë Pune dhe të figurojë në paktën në muajin e fundit në listëpagesat e OE.
- **Një punëtor ngarkim – shkarkim**, të vërtetuar me Kontratë Pune dhe të figurojë në paktën në muajin e fundit në listëpagesat e OE.

Argumentimi: Ky kriter eshte miratuar dhe vendosur nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me Kërkesat për kualifikim, në përputhje me Nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Ky kriter mbeshtetet edhe ne Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot "Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, sherbime". Ky kriter gjen mbeshtetje ne VKM nr.285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" te nenit 41 "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve", piken 4, ku percaktohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **b**)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose, **c**)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

5) Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një kontratë të vlefshme, të lidhur ndërmjet tij dhe një subjekti të licencuar (landfill), për të provuar asgjësimin final të produktit që rezulton pas trajtimit të mbetjeve spitalore (Hiri nga incenerimi, mbetjet e trajtuara nga autoklavimi).

Argumentimi: Kriteri 5 u vendos dhe përcaktua nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, qe kane specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike, si kriter i vendosur ne perputhje me germen c, te pikes 1 te nenit 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, ”Për prokurimin publik”, ne pikes 6 te nenit 41, VKM 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohen të gjitha kriteret e mundshme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Meqënë se objekti i kesaj procedure prokurimi eshte “Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 që gjenerohen nga shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universtare ‘Nënë Tereza’ për 24 muaj”, nga AK, në zbatim të legjislacionit që rregullon çështjet mjedisore si dhe nisur nga vetë natyra e procedurës së prokurimit të cilat në vetvetë, janë vendosur këto kriteret, në mënyrë që AK të krijojë bindjen.

6) Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka ne pronesi ose qira mjetet e pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si me poshte:

Lloji i makinerise (pajisjes)	Njesia	Sasia
Automjet te posaçëm*, të pajisur me sinjalistikën përkatëse për transport mbetjesh të rrezikshme spitalore	cope	1
Peshore e certifikuar me kapacitet mbajtës të paktën 100 kg	cope	5

- Per automjete qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin (çertifikaten e pronesise, leje qarkullimi (lëshuar nga DPSHTRR), Certifikatë e kontrollit teknik (i vlefshëm), Sigurim i përgjegjësisë ndaj palëve të treta (TPL), taksat vjetore (DPSHTRR), Leje Higjeno – Sanitare e Mjetit dhe Foto te Mjetit (brenda dhe jashte) ku të duket qartësisht targa dhe sinjalistika e detyrueshme sipas kërkesave të VKM 798, Datë 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.
- Ne rast eksporti te mbetjeve kerkohet edhe leja e qarkullimit nderkombetar dhe çertifikatë trajnimi profesional ADR për shoferin që do të drejtojë mjetin e kërkuar, për transport mallrash të rrezikshme, të vlefshem, si dhe çertifikaten e pronesise se mjetit së bashku me kontratën e qirasë/huapërdorjes kur mjeti është i marrë me qira.
- Pershorja duhet të jetë e çertifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

***Sgarim:** Mjeti i kërkuar si më sipër, duhet të jetë sipas përshkrimit: “plotësisht i mbyllur që ka një kabinë të ndarë, ose një automjet unitar në të cilën kabina e shoferit është e veçuar plotësisht nga ndarja ku vendosen mbetjet nga një paret i mbyllur i fiksuar”, sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore”, Seksioni: 9.3.3 ‘Atomjetet/anijet e grumbullimit’; Gjithashtu automjeti duhet të plotësojë edhe kriteret e pikës 8.8/c dhe shtojcën 4 të VKM nr.798 datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.

Argumentimi: Kriteret e përcaktuara në pikën 6) u vendosën nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, qe kane specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike, si kriter i vendosur ne perputhje me germen c, te pikes 1 te nenit 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, ”Për prokurimin publik”, ne pikes

6 te nenit 41, VKM 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohen të gjitha kriteret e mundshme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese dhe ky kriter gjen mbështetje në VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pikën 4, ku përcaktohet se: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç)mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

7) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një autodeklarate ku të deklarohej se ambalazhimi i mbetjeve spitalore do të kryhet në përputhje me pikën 8.4. dhe Shtojcën 2.A. dhe VKM Nr. 798, datë 29.9.2010 Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore" dhe Udhëzuesit Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore”.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 8.4. dhe Shtojcën 2.A. dhe VKM Nr. 798, datë 29.9.2010 Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore" dhe Udhëzuesit Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore”.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

- 1. Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03** duhet të realizohet nga impiante të licensuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (ish Ministria e Mjedisit) për kryerjen e këtij shërbimi.
- 2. Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03** duhet të realizohet me një prej metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara në VKM nr 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”

Mbetjet me kodin 18.01.02 “*Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset e gjakut dhe rezervat e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)*” do të asgjësohen me incenerim.

Mbetjet me kodin 18.01.03 “Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet” do të asgjësohen me sterilizim ose incenerim.

3. Mbetjet do të merren nga sipërmarrësi pranë ambjentit të shërbimit që do të vendoset nga Autoriteti Kontraktor / QSUT, me automjetet të posaçem në pronësi/qira, lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjeve të rrezikshme spitalore në përputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcën nr.4 te VKM-së Nr.798 dt.29.09.2010 dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhezuesin Kombëtar "Administrimi i sigurtë i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore". Tërheqja e mbetjeve do të bëhet sipas nevojave dhe kërkesës së AK -së.
4. Mbetjet e rrezikshme do të peshohen, fillimisht nga shërbimet që gjenerojnë e më pas do të peshohen në dorëzim nga grupi i punës ngritur me Urdhër të Brendshëm dhe Operatori Ekonomik, ku do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar, pa përfshirë kutinë e ambalazhimit të transportit. Ambalazhimi (kontenieret, kutite, qeskat, etj.) do të mbulohen nga subjekti fitues.
5. Stafi i çdo shërbimi ku gjenerohen mbetjet me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 ka për detyrë të regjistrojë peshën ditore të mbetjeve në regjistër ku të plotësohet **origjina e mbetjeve, lloji i mbetjeve (18.01.02 apo 18.01.03) dhe sasia në kg e mbetjeve**, përpara se të magazinohen në pikën e grumbullimit të përkohshëm, me qëllim që të kemi evidenca ditore të mbetjeve të gjeneruara. Grupi i punës ngritur me Urdhër të Brendshëm realizon peshimin total të mbetjeve të cdo shërbimi.
6. Operatori ekonomik do të kryejë furnizimin me kontenier dhe qeset përkatëse të ambalazhimit sa herë që tërheq sasinë e gjeneruara të mbetjeve dhe sa herë kërkohet nga Autoriteti Kontraktor. Kontenierët plastikë ose kuti kartoni me qese plastmasi duhet të jenë sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr.798 datë 29.09.2010 “Për Administrimin e mbetjeve spitalore” Pika 8/4 dhe 8/5 të Kreut III, Trajtimi i mbetjeve spitalore.
7. Operatori Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa praninë e përfaqësuesve të grupit të punës. Për kryerjen e shërbimeve operatori ekonomik duhet të paraqesë situacionin përmbledhës, dokumentat dhe faturat shoqëruese për sa është realizuar, në periudha kohore mujore përkatëse si dhe proces-verbalin për shërbimin e kryer të firmosur mes dy palëve (të operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit të sektorit që monitoron kontratën), dokumentacion për depozitim të hirit, depozitim të mbetjeve të trajtuara, printime të impiantit të trajtimit dhe informacion mbi realizimin e asgjësimit/sterilizimit të mbetjeve çdo fund muaji.
8. Peshimi i mbetjeve do të kryhet me peshore të kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë, që do të vihet në dispozicion nga operatori ekonomik fitues.

9. Operatori ekonomik duhet të instalojë një frigorifer për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme spitalore me kodin 18.01.02 deri në momentin e transportimit për në impiantin e asgjësimit sipas përcaktimeve të VKM 798/2010 “Për administrimin e mbetjeve” Kreu III, pika 8.5 b.
10. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, Operatori Ekonomik do të realizojë dezinfektimin e ambientit dhe frigoriferit, nga ku do të tërhiqen mbetjet e rrezikshme.
11. Personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/ kontejnerëve tranzit duhet të jetë kompetent dhe i trajnuar siç duhet, detyrim që buron nga pika 9.3.2 e Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurtë të Mbetjeve në vijim të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli I Lartë i Shtetit.
12. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik tek një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike sipas shtojcës 1 të VKM-së Nr.371, datë 11.06.2014 për “Përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, i ndryshuar. Dokumenti i dorëzimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a) numrin e dokumentit të dorëzimit;
 - b) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit;
 - c) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit;
 - ç) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim);
 - d) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve;
 - dh) përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasitë respektive;
 - e) hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrime të tyre.
13. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga procesi i sterilizimit në landfill të licencuar për mbetje jo të rrezikshme.
14. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga procesi i inçerimit (hiri) në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë miratuar dhe vendosur nga anëtarët e njesise së prokurimit që kanë specialitetin përkatës, në bazë të shkresës **nr. 545/9 Prot, datë 05.04.2024** “Argumentimi i Fondit Limit për procedurën me objekt “Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 që gjenerohen nga shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universtare ‘Nënë Tereza’ për 24 muaj”, bashkelidhur kërkeses për rihapje procedure nga Drejtoria e Shërbimeve Mbeshtetese nr. 545/19 Prot., datë 04.07.2024, të miratuara dhe nga Titullari i

Autoritetit Kontraktor, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te **Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik"**, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Shtojca 6

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 që gjenerohen nga shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", për 24 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj nga nënshkrimi i MK. Për kontratat e lidhura në baze të Marrëveshjes Kuadër, afati i ekzekutimit të shërbimeve do të jetë një vit nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Nr.	Emërtimi " <i>Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 që gjenerohen nga shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", për 24 muaj</i> "	Vendi i ekzekutimit	Sasia e parashikuar per 24 muaj
1	<i>Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02</i>	QSU "Nënë Tereza"	8,000 kg
2	<i>Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.03</i>	QSU "Nënë Tereza"	20,000 kg

Argumentimi: Sasia dhe afati i ekzekutimit janë vendosur ne baze te shkreses shkreses **nr. 545/10 Prot, datë 05.04.2024** "Argumentimi i Fondit Limit për procedurën me objekt "Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 që gjenerohen nga shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", për 24 muaj", bashkelidhur kerkeses per rihapje procedure nga Drejtoria e Sherbimimeve Mbeshtetese nr. 545/19 prot., datë 04/07/2024, te miratuara dhe nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, si dhe ne perputhje me **piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021** "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikonsasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.

Shtojca 7

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 që gjenerohen nga shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", për 24 muaj, **për realizimin e nevojave të Autoritetit Kontraktor QSUNT, si qendër spitalore terciare, e vetme në Republikën e Shqipërisë.**

Specifikimet teknike për procedrën e prokurimit me objekt: “Trajtimi i mbetjeve anatomike të lëngëta dhe të ngurta për QSU “Nënë Tereza” për 12 muaj”, janë bazuar në:

- Ligjin Nr.10463 datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”,
- Udhëzuesin Kombëtar të Administrimit të Sigurtë të Mbetjeve Spitalore;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.798 datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore;
- Ligjin Nr.8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- VKM Nr.99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” **i ndryshuar me VKM Nr.402 datë 30.06.2021;**
- Ligjin 10448, datë 14.07.2011 për Lejet e Mjedisit i ndryshuar;
- Rregulloren e Brendshme të Administrimit të Mbetjeve Spitalore të miratuar, me Nr.Prot.3501/6 datë 25.09.2018.
- VKM Nr.371, datë 11.06.2014 për “Përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme ”, i ndryshuar.
- Protokoll për kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor.

Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 duhet të realizohet nga impiante të licensuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (ish Ministria e Mjedisit) për kryerjen e këtij shërbimi.

Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 duhet të realizohet me një prej metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara në VKM nr 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”

- Mbetjet me kodin 18.01.02 “ *Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset e gjakut dhe rezervat e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)*” do të asgjësohen me incenerim.
- *Mbetjet me kodin 18.01.03 “Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet”* do të asgjësohen me sterilizim ose incenerim.
- Mbetjet do të merren nga sipërmarrësi pranë ambjentit të shërbimit që do të vendoset nga Autoriteti Kontraktor / QSUT, me automjetet të posaçem në pronësi/qira, lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjeve të rrezikshme spitalore në përputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcën nr.4 te VKM-së Nr.798 dt.29.09.2010 dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar "Administrimi i sigurtë i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore". Tërheqja e mbetjeve do të bëhet sipas nevojave dhe kërkesës së AK -së.

- Mbetjet e rrezikshme do të peshohen, fillimisht nga shërbimet që gjenerojnë e më pas do të peshohen në dorëzim nga grupi i punës ngritur me Urdhër të Brendshëm dhe Operatori Ekonomik, ku do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar, pa përfshirë kutinë e ambalazhimit të transportit. Ambalazhimi (kontenieret, kutite, qeskat, etj.) do të mbulohen nga subjekti fitues.
- Stafi i çdo shërbimi ku gjenerohen mbetjet me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 ka për detyrë të regjistrojë peshën ditore të mbetjeve në regjistër ku të plotësohet **origjina e mbetjeve, lloji i mbetjeve (18.01.02 apo 18.01.03) dhe sasia në kg e mbetjeve**, përpara se të magazinohen në pikën e grumbullimit të përkohshëm, me qëllim që të kemi evidenca ditore të mbetjeve të gjeneruara. Grupi i punës ngritur me Urdhër të Brendshëm realizon peshimin total të mbetjeve të cdo shërbimi.
- Operatori ekonomik do të kryejë furnizimin me kontenier dhe qeset përkatëse të ambalazhimit sa herë që tërheq sasinë e gjeneruara të mbetjeve dhe sa herë kërkohet nga Autoritetit Kontraktor. Kontenierët plastikë ose kuti kartoni me qese plastmase duhet të jenë sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr.798 datë 29.09.2010 “Për Administrimin e mbetjeve spitalore” Pika 8/4 dhe 8/5 të Kreut III, Trajtimi i mbetjeve spitalore.
- Operatri Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa praninë e përfaqësuesve të grupit të punës. Për kryerjen e shërbimeve operatori ekonomik duhet të paraqesë situacionin përmbledhës, dokumentat dhe faturat shoqëruese për sa është realizuar, në periudha kohore mujore përkatëse si dhe proces-verbalin për shërbimin e kryer të firmosur mes dy palëve (të operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit të sektorit që monitoron kontratën), dokumentacion për depozitim të hirit, depozitim të mbetjeve të trajtuara, printime të impiantit të trajtimit dhe informacion mbi realizimin e asgjësimit/sterilizimit të mbetjeve çdo fund muaji.
- Peshimi i mbetjeve do të kryhet me peshore të kolauduar nga Drejtoria Përgjithshme e Metrologjisë, pranë shërbimeve kryesore që gjenerojnë këto tipologji mbetjesh dhe në ambientin e grumbullimit final, në hidroklave, që do të vihet në dispozicion nga operatori ekonomik fitues (Në total 5 peshore, me kapacitet të paktën 100 kg, të kolauduara nga DPM, të cilat do të qëndrojnë pranë shërbimeve përgjatë gjithë MK dhe kontratave të lidhura brenda MK).
- Operatori ekonomik duhet të instalojë një banak frigoriferik të përshtatshëm për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme spitalore me kodin 18.01.02 deri në momentin e transportimit për në impiantin e asgjësimit sipas përcaktimëve të VKM 798/2010 “Për administrimin e mbetjeve” Kreu III, pika 8.5 b.

- Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, Operatori Ekonomik do të realizojë dezinfektimin e ambientit dhe frigoriferit, nga ku do të tërhiqen mbetjet e rrezikshme.
- OE duhet të vetedeklarojë që personeli i përfshirë në ngarkimin e koshave/ kontejnerëve tranzit duhet të jetë kompetent dhe i trajnuar siç duhet, detyrim që buron nga pika 9.3.2 e Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurtë të Mbetjeve.
- Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik tek një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike sipas shtojcës 1 të VKM-së Nr.371, datë 11.06.2014 për “Përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, i ndryshuar.
Dokumenti i dorëzimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a) numrin e dokumentit të dorëzimit;
 - b) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit;
 - c) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit;
 - ç) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim);
 - d) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve;
 - dh) përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasi të respektive;
 - e) hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimit e tyre.
- Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga procesi i sterilizimit në landfill të liçensuar për mbetje jo të rrezikshme.
- Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga procesi i inçerimit (hiri) në një subjekt të liçencuar për depozitimin e hirit.

Shpërndarja: 24 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Qendra Spitalore Universitare ”Nene Tereza” Tirane

Argumentimi: Termit e referencës janë vendosur ne baze te shkreses **nr. 545/9 Prot, datë 05.04.2024** “ *Argumentimi i Fondit Limit për procedurën me objekt “Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 që gjenerohen nga shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universtare ‘Nënë Tereza’ për 24 muaj*”, bashkelidhur kerkeses per rihapje procedure nga Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese nr. 545/19 Prot., datë 04.07.2024, te miratuara dhe nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, si dhe ne perputhje me **piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021** “*Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik*”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.*

Përlllogaritja e Fondit Limit, specifikimet teknike, termat e referencës, grafiku i ekzekutimit, sasia etj., janë vendosur ne mbështetje te Argumentimit të Fondit Limit **nr. 545/9 Prot, datë 05.04.2024** “ *Argumentimi i Fondit Limit për procedurën me objekt “Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve me kodin 18.01.02 dhe 18.01.03 që gjenerohen nga shërbimet spitalore të Qendrës Spitalore Universtare ‘Nënë Tereza’ për 24 muaj*”, bashkelidhur kerkeses per rihapje procedure nga Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese nr. 545/19 Prot., datë 04.07.2024

Akordimi i Fondit është miratuar nga Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar me Shkresën **nr. 545/11 prot., datë 30.04.2024.**

Periudha e vlefshmërisë së ofertave: **150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë.**

Kriteri i vlerësimit: **Çmimi më i ulët.**

Data e zhvillimit te tenderit te jete data **Data: 22.07.2024, Ora: 10:00**

NJËSIA E PROKURIMIT